



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

RAPORT

PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNAVE NË
MITROVICËN E VERIUT, ZUBIN POTOK, LEPOSAVIQ, ZVEÇAN DHE PËR ZGJEDHJET E
PARAKOHSHME PËR KUVENDET E KOMUNAVE LEPOSAVIQ DHE ZVEÇAN

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP
Prishtinë, Janar 2024

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë
info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	2
Hyrje.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Korniza ligjore.....	5
Përbërja dhe mandati i PZAP-it.....	6
Aktiviteti për periudhën raportuese.....	6
Aktivitet e PZA-it lidhur me ankesat e eventuale gjatë procesit zgjedhor.....	7
Aktivite shtesë të realizuara.....	7
Bashkëpunimi me akteret e tjerë të zgjedhjeve.....	9
Përfundimi.....	10

LISTA E SHKURTESAVE

PZAP - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
PK – Policia e Kosovës
MF - Ministria e Financave
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme – Administrata Publike
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale
ZYRA - Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike
SP- Subjektet Politike
KP – Kandidat i Pavarur
QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve

Hyrje

Ne bazë të nenit 115 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP-së) Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa /PZAP-ja, obligohet që të dorëzon Raport Vjetor Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më së largu më 1 mars të vitit pasues pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe pas shqyrtimit të tij, i njëjti publikohet.

Ne përputhje me paragrafin 5 të nenit 115 të LZP-së, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, obligohet që në kuadër të raportit vjetor lidhur me sistemin e drejtësisë të cilin ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 8 të nenit 108 të Kushtetutës, në një kapitull të veçantë të saj, përmbledh edhe punën e PZAP-së për vitin në të cilin janë mbajtur zgjedhjet.

PZAP, në Planin e Punës për vitin 2023 ka përfshi si aktivitet edhe Përgatitjen e Planit të Veprimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe planin e veprimit për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq.

Raporti i punës së PZAP-së, pasqyron aktivitetet e realizuara për;

- zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe
- zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave; Zveçan dhe Leposaviq.

Përmbledhje ekzekutive

Presidentja e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.76 të datës 14 Nëntor 2022 ka caktuar dhe shpallur datën 18.12.2022 për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, ndërsa me vendimin Nr.77, të datës 25 Nëntor 2022, ka caktuar dhe shpallur datën 25.12.2022 për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, janë caktuar dhe shpallur pas dorëheqjeve të kryetareve të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, ndërsa zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq janë caktuar dhe shpallur pas shpërbërjes së kuvendeve të Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Në zbatim të mandatit të tij të përcaktuar me nenin 115 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP-së, dhe Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq.

PZAP-i, nën udhëheqjen/drejtimin e kryesuesit të PZAP-it z. Shukri Sylejmani, me datën 22.11.2022 ka mbajtur takimin e rregullt me anëtarët e PZAP-it si, dhe stafin e sekretariatit të PZAP-it, me qëllim të marrjes së vendimeve për të planifikuar objektivat dhe aktivitetet për këto zgjedhje si vijon:

- Vendimin Nr. 69, të datës 22.11.2022 për miratimin e Planit të veprimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq;
- Vendimin Nr. 70, të datës 22.11.22 për zgjatjen e orarit të punës për personelin e Sekretariatit të PZAP-it (SPZAP) gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Përkundër përgatitjes dhe miratimit të planit të veprimit dhe kryerjes së disa aktiviteteve për zgjedhjet e theksuara më lartë, për arsye objektive ato nuk janë mbajtur, respektivisht me vendimin Nr.79/2022 të datës 10.12.2022 të Presidentes së Republikës së Kosovës, këto zgjedhje janë shtyrë dhe është caktuar data e re e mbajtjes së tyre me datën 23.04.2023.

PZAP-i, deri në marrjen vendimit Nr.79/2022 të datës 10.12.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës për shtyrjen dhe caktimin e datës se re të zgjedhjeve, në bazë të mandatit të përcaktuar me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të plotfuqishme, ka kryer edhe disa aktivitete tjera të ndërlidhura me këto dy procese zgjedhore siç janë:

- njoftimi i KQZ-së, në lidhje me gjobat e papaguara të subjekteve politike, dhe
- njoftimi i KQZ-së më të dhënat për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia /PZAP gjatë këtij procesi zgjedhor, ka pranuar dy (2) apele nga një subjekti politik.

Korniza ligjore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia/PZAP, gjatë realizimit të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave, bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare, për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, subjekteve politike, dhe aktereve tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen lidhur me kontestet zgjedhore. Vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrëhet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme e Kosovës e vendos ndryshe, e cila Gjykatë është instanca e fundit e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia/PZAP, për trajtimin e ankesave/apelleve të subjekteve politike dhe aktereve të tjerë me të drejtë ankese, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për kuvendet e

Komunave Zveçan dhe Leposaviq, të mbajtura ne vitin 2023; ka zbatuar komizën ligjore primare dhe sekondare të legjislacionit në fuqi, si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr.03/L-256 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës;
- Rregullat Zgjedhore të KQZ-së;
- Rregulloren Nr. 01/2022 Për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave dhe Apeleve.

Mandati dhe Përbërja e PZAP-it

PZAP, është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar Ligjin Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat zgjedhore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit.

PZAP-i përbëhet prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve përfshi kryesuesin të cilët shërbejnë për një mandat të ripërtërishëm prej katër (4) viteve.

Aktiviteti për periudhën raportuese

Aktiviteti për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq që janë mbajtur më 23.04.2023

PZAP për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme që janë mbajtur më datën 23.04.2023 në komunat veriut të Kosovës në përputhje me aktet e plotfuqishme ligjore dhe nënligjore ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të kryer aktivitetet lidhur me pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave eventuale për këto zgjedhje.

PZAP-i, si në çdo proces zgjedhor edhe për këto zgjedhje duke u bazuar në mandatin e tij të përcaktuar me LZP dhe Rregullat Zgjedhore, vendimin e presidentes për shpalljen e zgjedhjeve, praktikat e mira nga zgjedhjet e kaluara si dhe duke marrë për bazë edhe Planin Operacional të KQZ-së, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq, në të cilin plan janë të paraqitura afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore nga KQZ-ja, ka përgatitur Planin e veprimt të PZAP-i, në të cilin plan janë paraqitur afatet kohore për zbatimin e

aktiviteteve të PZAP-it, pasi që vendimet e KQZ-së, lidhur me këto aktivitete zgjedhore ndikojnë edhe në aktivitetet operacionale të punës së PZAP-it.

Në Planin e veprimit të PZAP-it, për këto zgjedhje janë paragjitur aktivitetet që kanë të bëjnë me ankesat eventuale lidhur me:

- Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Komisioneve Komunale të zgjedhjeve ,
- Aplikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje,
- Certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje,
- Tërheqjen e kandidatëve nga shorti i fletëvotimit dhe afati i zëvendësimit të kandidatëve,
- Aplikimin për regjistrim si votues jashtë Kosovës,
- Aplikimin për regjistrim si votues me nevoja të veçanta,
- Periudhën e Votimit Jashtë Kosovës,
- Certifikimin e Listës së Votuesve,
- Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve,
- Periudhën e fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike,
- Aplikimin për akreditim të vëzhguesve,
- Për thyerjen e heshtjes zgjedhore.
- Parregullsitë/shkeljet për ditën e Zgjedhjeve,
- Pranimin e ankesave nga Qendra e Numërimit të Rezultateve/ QNR,
- Me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja,
- Shkresën konfirmuese të PZAP-it, për KQZ-në, për të Certifikuar Rezultatet e Zgjedhjeve ,
- Dorëzimin e Raportit financiar të fushatës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe,

Aktivitetet tjera shtesë të realizuara si vijon:

- Shkresa njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në, lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike nga zgjedhjet e kaluara për tu certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje,
- Shkresa njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në, më të dhënat për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.
- Shpërndarja e Formularëve të ankesave në gjuhën shqipe dhe serbe në të gjitha Qendrat e Votimit/QV, ku qytetaret kanë mundur të parashtrajnë ankesa për parregullsitë eventuale në ditën e zgjedhjeve.

Anëtarët e PZAP-it, përfshi kryesuesin dhe stafin e sekretariatit në përputhje me mandatin e tyre të përcaktuar me LZP dhe dokumentet e miratuara nga vet PZAP-i, kanë qenë në gatishmëri dhe i kanë kryer me profesionalizëm të gjitha këto aktiviteteve prej shpalljes së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve që janë mbajtur me 23.04.2023.

Për këtë proces zgjedhor nga subjektet politike në PZAP janë dorëzuar vetëm dy (2) apele, një (1) para shtyrjes e një (1) pas shtyrjes se zgjedhjeve dhe ato janë si vijon:

PZAP-i për këto dy (2) apele ka mbajtur tri (3) seanca dhe të njëjtat i ka shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor.

1. Seanca e parë (1) është mbajtur me datën 08.12.2022 lidhur me apelin Anr.1/2022 të datës 06.12.2022,
2. Seanca e dytë (2) është mbajtur me datën 05.05.2023 lidhur me apelin Anr.1/2023 të datës 05.05.2023 dhe,
3. Seanca e tretë (3) është mbajtur me datën 12.05.2023 me rastin e rivendosjes së apelit Anr.1/2023 të datës 05.05.2023, sipas vërejtjeve të dhëna me Aktvendimin AA.nr.17/2021 të datës 10.05.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

1. Para shtyrjes së zgjedhjeve PZAP-i, ka pranuar një (1) apel, apelin Anr.1/2022 të datës 06.12.2022 të paraqitur nga një (1) subjekti politik, si palë me interes - ankuesi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1577-2022 datë 05.12.2022, për shkak të mos certifikimit të 14 kandidatëve të këtij subjekti për zgjedhjet e parakohshme për anëtarë të Kuvendit Komunal në Leposaviq.

PZAP-i, pas administrimit të shkresave të lëndës, ka vendosur që të pranoj apelin e subjektit politik-ankuesit si të bazuar, ndërsa vendimin e ankimuar të KQZ-së, ta anuloj dhe çështjen të ja kthej në rivendosje KQZ-së, ku KQZ në ri procedurë është urdhëruar nga PZAP-i, që ta rishqyrtonte rekomandimin e Zyrës edhe për 14 kandidatët e këtij subjekti të cilët nuk ishin certifikuar nga KQZ-ja, e që janë propozuar për certifikim nga subjekti politik - ankues, dhe se për të njëjtit pas vlerësimit dhe verifikimit nga Zyra si dhe plotësimit të kushteve ligjore nga neni 29 i LZP-së, duke respektuar edhe kuotën gjinore, të merret vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

2. Pas shtyrjes së zgjedhjeve PZAP-i, ka pranuar edhe një (1) apel, apelin Anr. 01/2023 të datës 05.05.2023, të paraqitur nga një (1) subjekti politik, si palë me interes - ankuesi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/592-2023 i datës 04.05.2023, lidhur me Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhje të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq. PZAP-i e ka refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit politik, palës ankuese dhe kishte vërtetuar vendimin e KQZ-së.

Ndaj këtij vendimi subjekti politik, si palë me interes - ankuesi, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, ku e njëjta Gjykatë me Aktvendimin e tij me nr. AA 11/2023 të datës 10.05.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e subjektit politik - ankuesit, ndërsa vendimin e PZAP-it, Anr. 01/2023 të datës 05.05.2023 e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

PZAP-i, pas pranimit të aktvendimit AA.nr.17/2021 të datës 10.05.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur nga subjekti politik – ankuesi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e lartcekur, në procedurë të rivendosjes ka vendosur se apeli i subjektit politik - ankuesit, është i palejuar pasi që dispozitat ligjore të Ligjit për

Zgjedhjet Lokale dhe as dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konkretisht neni 122, nuk përcakton të drejtën e ankimimit të subjekteve politike pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, përkatësisht asnjë nga rregullat zgjedhore nuk lejon parashtrimin e ankimimit kundër vendimit për certifikimin të rezultateve zgjedhore, sepse rezultatet certifikohen pas përfundimit të gjitha procedurave, në QNR, procedurave të ankimimit në PZAP dhe procedurave të ankimimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe pas kësaj certifikohen rezultatet ku nuk është i lejuar ankimimi sepse përfundon i tërë procesi zgjedhor.

Vendimet e PZAP-i, janë të publikuara në ueb faqen e PZAP-it, dhe në kopje fizike iu janë dorëzuar palëve.

Bashkëpunimi me akteret e tjerë të zgjedhjeve

Ne bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 30.09.2020 për Procesin Zgjedhor në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur të Mediave PZAP, ka implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum. Niveli i bashkëpunimit me akterët e këtij memorandumi është ngritur në veçanti pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 23 Prill 2023.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit është mbajtur takimi i organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për zgjedhjet e shpallura, Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 23 Prill 2023

Temat e takimit kryesisht ka qenë lidhur me Sigurinë për zgjedhjet në Komunitat e Veriut të caktuara në Prill të vitit 2023.

Përveç këtij takimi dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it, dhe KQZ-së, ka pasur shkëmbim të informatave lidhur me ankesat e paraqitura në PZAP-it, para shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në Komunitat e Veriut, njoftimin me vendvotimet e Zgjedhjeve në Komunitat e Veriut të mbajtura me 23 Prill 2023, materialet e të cilave janë objekt hetimi penal si dhe për shumë aktivitete të tjera.

Përfundim

- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i duke u bazuar në mandatin e tij të përcaktuar me LZP dhe Rregullat Zgjedhore, vendimin e presidentes për shpalljen e zgjedhjeve si duke i marre për bazë mësimet dhe praktikat e mira nga zgjedhjet e kaluara edhe për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme që janë mbajtur me 23.04.2023 në komunat e veriut të Kosovës, pa paragjykuar se sa ankesa mund të paraqitën në PZAP, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të planifikuar aktivitetet e PZAP-it dhe angazhimin kapaciteteve njerëzore dhe financiare për kryerjen/zbatimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për pranimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve lidhur me ankesat si dhe njoftimin e palëve dhe publikut me këto vendime.
- Anëtarët e PZAP-it, përfshi kryesuesin, gjatë kësaj periudhe prej shpalljes e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i kanë dhënë përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të PZAP-it, edhe pse gjatë këtij procesi zgjedhor në PZAP, janë paraqitur vetëm dy apele të cilat PZAP-i, i ka shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor.
- Zyrtaret e sekretariatit të PZAP-it në mbështetje të panelit po ashtu kanë ndihmuar panelin në marrjen e të gjitha vendimeve lidhur me apelet që janë paraqitur në PZAP, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion. Zyrtaret sipas nevojës dhe arsyes janë angazhuar dhe kanë punuar edhe pas orarit të punës si dhe kanë qenë të gatshëm për të kryer të gjitha aktivitetet gjatë gjithë procesit zgjedhor nga dorëzim pranimi i ankesave dhe apeleve deri të njoftimi i palëve dhe publikut me vendimet lidhur me apelet.
- Për shkak se aktivitetet e PZAP-it, të planifikuara për këto zgjedhje kanë pas implikime të vogla buxhetore, PZAP-i, nuk ka kërkuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - MFPT, buxhet shtesë për Paga dhe Mëditje dhe për Mallra dhe Shërbime për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të PZAP-it, pasi që institucioni ka pas në dispozicion mjete të mjaftueshme buxhetore të miratuar me buxhetin e vitit 2023, si dhe ka pas në dispozicion mjaft Formularë të ankesave për me i shpërndare në Qendrat e Votimit në ditën e zgjedhjeve.
- Për këto zgjedhje PZAP-i, nuk ka shqiptuar asnjë gjobë ndaj subjekteve politike.
- Për shkak të mungesës së rasteve për këtë proces zgjedhor PZAP-i, në Prokurorinë e Shtetit-PSH, nuk ka dorëzuar asnjë rast të ankesave me element të veprës penale.
- Për shkak të mungesës së rasteve për këtë proces zgjedhor PZAP-i, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, nuk ka dorëzuar të dhënat për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.